



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 119

Prishtinë, më 26.6.2013, ora 10,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Nijazi Idrizi.

Mungoi : Boban Todorović dhe Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi dhe Flaka Broqi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 24.6.2013,
3. Shqyrtimi i problemit të përhapjes së etheve hemorragjike nga rriqrat,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.6.2013

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 24.6.2013.

3. Shqyrtimi i problemit të përhapjes së etheve hemorragjike nga rriqrat

Kryetari Nait Hasani përshëndeti të pranishmit, veçanërisht ministrin **Ferid Agani**, kryeshefin **Valdet Gjinovcin** dhe drejtorin **Naser Ramadani** të cilët komisioni i ka ftuar për mbledhjen e sotme rreth sëmundjes së etheve hemorragjike e cila rrezikon jetën e popullatës (gjatë këtij viti deri tani janë evidentuar 5 raste të vdekjes) dhe përsëritet çdo vit përafërsisht në të njëjtin periudhë të vitit. Për të ofruar sa më shumë informata rreth mbrojtjes së jetës së njeriut, kryetari ftoi fillimisht ministrin **Ferid Agani** i cili brengat e përbashkëta dhe preokupimin ndau në 5 çështje kryesore :

1. **buxheti** (puna enorme për të gjetur vaksinën),
2. **ndihmat rajonale** (ende nuk është identifikuar ndihma konkrete rajonale përveç informimit) ,
3. **vonesat në veprime** (shteti nuk është vonuar por pacienti i cili nuk ka lajmërua),
4. çështja se **çka është ndërmarr deri tani** (nuk ka vend për panik) dhe
5. **frika e popullatës** (kontrollimet e shpeshta dhe fushata mediale).

Megjithatë ai në fillim foli për gjenezën dhe theksoi se kjo sëmundje ka filluar qysh në vitin 1956 dhe çdo herë përsëritet, fatkeqësisht me rritje. Bartës kryesor i sëmundjes-virusit është krime kongo me trend vdekjeprurës por që eliminohet nëse zbulohet heret. Dimensioni i parë i angazhimit të Kosovës është se vendi ynë është bashkëngjitur më 2011 hulumtimit panevropian lidhur me këtë sëmundje për të zbuluar virusin (Kosova Hoti) në funksion të gjetjes së vaksinës, ndërsa dimensionin e dytë i angazhimit është edukimi i popullatës, ngase deri tani nuk është zbuluar bari që shkatërron këtë sëmundje (virus). Duhet të sqarohet një gjë, vazhdoi, IKSHK (Instituti) nuk i mbyl rriqrat (këtë e bënë AUV) por identifikon virusin duke trajtuar në klinikën e sëmundjeve ngjitëse dhe duke inkorporua virusin RIBAVIRIN. Momentalisht janë 52 raste , 16 pozitiv pa rrezik për jetë. Shkatërrimi i rriqrave është tepër proces i vështirë, sqaroi më tutje ministri, ngase ato futen thellë në tokë.

Drejtori i IKSHK Naser Ramadani fillimisht pohoi se AUV është ajo që kujdeset për shkatërrimin e rriqrave nëpër zonat e shfaqura, ndërsa instituti deri tani ka identifikuar 112 vatra në periudhën e deritanishme 12 vjeçare me çka konsiderohet se Kosova luan rol të rëndësishëm në vendet e rajonit lidhur me aktivitetet e zhvilluara sa i përket sëmundjes në fjalë me të dhëna interesante. Rreth pyetjes pse ka ndodhur sivjet kjo sëmundje në Malishevë, ai sqaroi se doktoresha me prejardhje greke ka dhënë kontribut në këtë drejtim ngase fjala është për vendet me ekosistem dhe ekologji të ngjashëm, në kufirin Turk në vendin e quajtur KOMOTIN ka ethe hemorragjike i cili ka pasqyrë të ngjashme sikurse Malisheva dhe Rahoveci, por normalisht Grekët nuk publikojnë këtë për shkak të ruajtjes së zhvillimit të turizmit. Nuk është çdo lloj i rriqrave i rrezikshëm por vetëm dy tre lloje, zakonisht rriqëri tialloma bart sëmundjen e etheve hemorragjike, vazhdoi, poashtu ka edhe në Gërmi, por ata janë në shumicë në shtallat ku ka shtazë-bagëti, ndaj në favor të kësaj janë angazhuar 40 puntorë sezonal enkas dhe tremujor (pranvera është koha e rriqrave). Nga 2667 pickime 17 raste janë pozitive sipas metodës rical time, prej vitit 2009 ka pasur 9.900 pickime me 72 raste dhe 16 raste të vdekjes. Nëse pacienti pas pickimit nuk shkon në spital, sëmundja merr hov. Çelësi i suksesit sipas tij është ndarja e buxhetit (156.000 euro janë ndarë sivjet për IKSHK nga MSH) dhe strategjia ende e pa miratuar, por ndërhyri ministri : asgjë nuk garanton suksesin nëse nuk ka punë të përbashkët.

Valdet Gjinovci nga AUV falënderoi për bashkëpunimin me IKSHK dhe njoftoi se agjencia për veterinarin ka kontribua me 156 kg material dezinfektues, 300 serume, përcaktime të shtameve etj. **Nait Hasani** falënderoi për sqarimet e dhëna dhe ftoi anëtarët e komisionit për të parashtruar pyetje nëse kanë. **Salih Morina** si banor i vendit ku janë shfaqur rriqrat apeloj për angazhim të shtuar të MSH, AUV dhe IKSHK duke potencuar faktin e mungesës së buxhetit por joreal, ngase dezinfektimet janë bërë në mënyrë selektive (vende vende), kjo është e pafalshme siç tha ai sepse në vend se të shtrohet 1 km asfalt mund të financohet dezinfektimi i vendeve të rrezikuara, gjithashtu potencoi faktin e moszbatimit të strategjisë nga viti 2007 por edhe pyeti a ka strategji që eliminon këtë sëmundje, duke ftuar që vitin e ardhshëm të janë institucionet më të hershëm dhe më përfshirës. **Liburn Aliu** fajin kryesorë e përqendroi në mungesën e bashkëveprimit të Qeverisë si trup i vetëm, ngase kështu me veprime të ndara asgjë nuk arrihet, gjithashtu theksoi

mosndryshimin e gjendjes ekzistuese deri tani-pasi nuk ka avansim, edhe pse ka pasur angazhime të cilat i dëgjoji dhe nuk i mohoi. **Ministri Agani** ndërhyri dhe pohoi se ka pasur punë evidente sipas rezultateve konkrete edhe pse nuk ka pasur strategji që nga viti 2003, gjithashtu tha se këtu kemi të bëjmë edhe me ekosistem (përveç sistemit-shtetit), ndaj nuk bënë këto gjëra të politizohen. Në **polemikën midis Ministrisë dhe Liburn Aliut** : pse bohet strategjia, ministri potencoi : për me zvogëluar problemin, ngase nuk ka strategji në botë që ndalon ethet hemoragjike. **Afërdita Berisha** pyeti a nuk është muaji prill kur duhet të intervenohet dhe a ka mundësi që MSH të angazhohet më tepër në vetëdijesimin e popullatës (të sqarohet p.sh. edhe që bëhet pickimi ende nuk është fatale nëse intervenohet me kohë), ndërsa ministri tha pikërisht më 16 prill ka filluar aksioni i dezinfektimit në Malishevë dhe u angazhua që do të bëjë fushatë të fuqishme mediale ngase si tha ai pikërisht këtu jemi vonuar dhe këtu duhet të përqendrohet hapësira e veprimit. **Sevdije Lama** japi mbështetjen e sajë duke potencuar edhe vatra tjera të veprimit, ndërsa **Nijazi Idrizi** potencoi faktin se tani nuk ka vend për krenari por për angazhim dhe ngushëllim për rastet e vdekjes që ndodhën sivjet, sidomos duhet angazhim rreth eliminimit të frikës nga popullata duke sqaruar se intervenimi i shpejt është zgjidhja më e mirë.

Rasim Demiri potencoi faktin se këto pickime ndodhin më tepër nëpër fshatra, ndaj apeloi për fushatë edukuese mediale për fshatarët të cilët nuk shkojnë menjëherë te mjeku por intervenojnë vet, ngase si tha ai paska rriqra të rrezikshëm por edhe jo të rrezikshëm.

Kryetari Nait Hasani në fund falënderoi shumë për sqarime duke shprehur keqardhje për rastet të vdekjeve të deritanishme dhe duke apeluar në zbatimin e premtimeve të dhëna në këtë mbledhje nga MSH dhe AUV por edhe nga IKSHK.

Komisioni në fund u konsultua për vizitën në Kroaci që do të financohet nga MMPH.

Mbledhja përfundoi në orën 12,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani